

RELACION

PËR

AKTIN NORMATIV “PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.92/2014, “PËR TATIMIN MBI VLERËN E SHTUAR NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky akt normativ ka për qëllim përjashtimin nga detyrimi i pagimit të tatimit mbi vlerën e shtuar për mallrat dhe pajisjet e projektuara posaçërisht ose të përshtatura për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale për luftë dhe që janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo janë modifikuar për përdorim ushtarak, përfshirë ato të cilat importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.

Qëllim tjetër i aktit normativ është edhe përfshirja në përjashtimet nga pagesa e TVSH-së e mjeteve dhe pajisjeve të cilat përdoren për të rindërtuar zonat e prekura nga fatkeqësitë. Këtë përjashtim e kemi kufizuar në rastet dhe afatet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore. Këto dy elemente janë pjesë e fushës së përgjegjësisë së Ministrisë së Mbrojtjes dhe përfaqësojnë një interes publik madhor. Mbrojtja kombëtare dhe ajo civile janë në bazë të piramidës së nevojave të një kombi sepse kanë të bëjnë me vetë mbijetesën dhe vetë prezervimin e tij.

Për mjetet dhe pajisjet ushtarake që do të importohen nga vende të NATO-s dhe vendeve të tjera aleate, si dhe ato materiale dhe pajisje që do të përdoren për rindërtimin e zonave të fatkeqësisë, nuk duhet të krijohen barrierë financiare. Ato duhet të bëhen drejtpërdrejt të aksesueshme dhe të futen menjëherë në territorin e Republikës së Shqipërisë pa detyrime doganore ose tatime dhe taksa për vetë qëllimin e përdorimit të tyre.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Akti normativ nuk është parashikuar në programin e përgjithshëm analitik të projektakteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2019, për Ministrinë e Mbrojtjes.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Përparësia kryesore e të gjithë organeve shtetërore në këto ditë zie kombëtare është ndihma sa më e shpejtë dhe reagimi i menjëhershëm për përballimin e situatave të tilla në të ardhmen. Përgatitja dhe provigjonimi për situata të cilat cenojnë sigurinë kombëtare duhet të jenë gjithmonë prioritare, në çdo vendimarrje të organeve shtetërore dhe jo vetëm.

Në kuadër të sa më sipër dhe të partneritetit me vendet e NATO-s dhe vendeve të tjera aleate Ministria e Mbrojtjes është shpesh herë subjekt përfitues i mjeteve dhe materialeve për qëllimet e sipërcituara. Aleatët, për të ndihmuar në forcimin e mekanizmave të mbrojtjes kombëtare dhe mbrojtjes civile, i vënë në dispozicion Ministrisë së Mbrojtjes si organ specifik që ka në fushën e përgjegjësisë mbrojtjes kombëtare dhe atë civile, asete dhe materiale të ndryshme ushtarake dhe për rindërtimin e zonave të prekura nga fatkeqësitë natyrore.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projekt akt normativ është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Projekt akti normativ propozohet në bazë të nenit 101 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Në nenin 101 të Kushtetutës përcaktohet:

“Këshilli i Ministrave, në rast nevoje dhe urgjence, nën përgjegjësinë e tij, mund të nxjerrë akte normative që kanë fuqinë e ligjit, për marrjen e masave të përkohshme. Këto akte normative i dërgohen menjëherë Kuvendit, i cili mbledhet brenda 5 ditëve nëse nuk është i mbledhur. Këto akte humbasin fuqinë që nga fillimi, në qoftë se nuk miratohen nga Kuvendi brenda 45 ditëve”.

Urgjenca dhe nevoja, të parashikuara nga neni i sipërcituar i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në rastin konkret justifikohen nga situata e krijuar nga fatkeqësia natyrore (tërmeti) i ndodhur në datë 26.11.2019. Ndodhi e cila diktoi shpalljen e gjendjes së fatkeqësisë natyrore për shkak të pasojave të rënda që solli në dëme materiale dhe në jetë njerëzish. Bilanci i viktimave, të lënduarve dhe dëmeve material është në rritje të vazhdueshme.

Në këtë situatë të gjithë vendet aleate kanë kontribuar me mjete materiale dhe mjete, për të ndihmuar në përballimin e gjendjes së krijuar nga pasojat e tërmetit

dhe rindërtimin e zonave të dëmtuara. Këto të mira materiale kur alokohen, importohen ose dërgohen në RSH, janë subjekt i skemës së TVSH-së dhe për këtë arsye, pas pikës 28 të nenit 56 të ligjit nr. 92/2014, duhet të shtohet fjalia “... përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar...”, duke i çliruar këto sende nga ky detyrim brenda kushteve dhe afateve të sipërcituara.

Gjithashtu, si subjekt i këtij akti normativ, janë përfshirë edhe materialet që importohen për qëllime të mbrojtjes kombëtare. Në raste të shumta Ministria e Mbrojtjes nuk ka mundur të importojë materiale dhe pajisje ushtarake nga shtetet aleate, për shkak të pamundësisë së pagimit të TVSH-së për to. Importimi përdorimi i këtyre materialeve dhe pajisjeve ushtarake, do të kishte pasur një ndikim të paçmueshëm në rritjen e kapacitetit të mbrojtjes dhe sigurisë kombëtare dhe nuk duhet të jenë pjesë e skemës së TVSH-së për shkak se janë jashtë qarkullimit civil dhe nuk rishiten nga Ministria e Mbrojtjes për arsye të vetë natyrës së tyre.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME ACQUIS TË BE-SË (PËR PROJEKTAKTET NORMATIVE)

Akti normativ nuk synon përafrimin me legjislacionin komunitar.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ndodhitë e datës 26.11.2019 kanë krijuar një situatë për zgjidhjen e së cilës kanë ofruar ndihmë të trupëzuar në mjete materiale, të cilat duhet të importohen në Republikën e Shqipërisë. Gjithashtu, ka lindur nevoja për të rritur kapacitetet reaguese në raste të tilla nga strukturat përgjegjëse për mbrojtjen kombëtare dhe mbrojtjen civile. Për këtë arsye, lind nevoja e përjashtimit nga pagimi i TVSH-së të materialeve dhe pajisjeve të cilat përdoren për këto qëllime.

Për përjashtimin e këtyre sendeve nga skema e TVSH-së është e nevojshme një ndryshim në nenin 56, pika 28, dhe një shtesë pas pikës 42, si dhe shfuqizimi i fjalisë së dytë, të pikës 2, të nenit 77, të ligjit nr.92/2014, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Konkretisht, neni 1 i projektaktit normative përcakton se:

1. Në fund të pikës 28 shtohet paragrafi i mëposhtëm:
“... përjashtuar materialet dhe pajisjet e importuara për këtë qëllim nga organe shtetërore për rastet e shpalljes së “gjendjes së fatkeqësisë natyrore” brenda afatit të përcaktuar.”

2. Pas pikës 42 shtohet pika 43, me këtë përmbajtje:

“43. Mallrat dhe pajisjet për qëllime ushtarake dhe që përdoren si armë, municion apo bazë materiale luftarake dhe të cilat janë projektuar, zhvilluar, prodhuar, montuar apo modifikuar për përdorim ushtarak, që importohen në emër të Ministrisë së Mbrojtjes.”.

Neni 2 përcakton shfuqizimin e fjalisë së dytë të pikës 2, të nenit 77, të ligjit 92/2014, i cili ka përmbajtjen, si më poshtë vijon:

“Tatimi mbi vlerën e shtuar për importimin e materialeve ushtarake për Forcat e Armatosura, të dhuruara nga vendet anëtare të Aleancës së NATO-s apo partnerët, paguhet si kosto lokale nga Ministria e Mbrojtjes.”.

Shfuqizimi i kësaj pike vjen si pasojë e shtesave të bëra në nenit 56, të ligjit sepse këto materiale janë përfshirë në përjashtimet nga pagesa e TVSH-së. Pra, nuk mund të ekzistojnë në projektligj dy dispozita të cilat bëjnë rregullime diametralisht të kundërta me njëra-tjetrën.

Neni i tretë aktit normativ parashikon hyrjen e menjëhershme në fuqi të tij dhe detyrimin për botim në “Fletoren zyrtare”.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e këtij akti normativ ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Akti normativ është dërguar për mendim në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrinë e Drejtësisë.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Akti normativ nuk ka efekte financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE